

Relacion mbi hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit

1. Lista e përmbajtjes së raportit të monitorimit të buxhetit

- Hyrje
- Informacion buxhtor i agreguar
- Performanca e treguesve kyç të performancës në bazë gjinore, nivel produkti
- Performanca e buxhetit në nivel programi
- Projektet kapitale
- Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit)
- Përfundime, ndryshime në buxhet

2. Hyrje

Programi “Menaxhimi i të Ardhurave Doganore” është pjesë e grupit 10 Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe përbëhet nga 19 njësi ekonomike (Aparati + 18 Degë Doganore). Buxheti i akorduar programit është bazuar në Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA-së 2026-2028. Politika buxhetore e programit është fokusuar në përmbushjen në kohë të objektivave dhe detyrimeve ligjore si dhe të angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në proceset e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për periudhën Janar-Prill 2026 për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar për të siguruar realizimin e qëllimit dhe objektivave të synuara të Institucionit. Nëpërmjet këtyre raporteve të monitorimit evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të miratuara në nivel kapitulli si dhe artikulli buxhetor si dhe treguesve të performancës dhe produkteve të parashikuara për tu realizuar. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për periudhën Janar-Prill 2026, paraqitet si më poshtë vijon:

Në 000 lekë

Titulli	Emri i Programit	Buxheti fillestar 2026	Buxheti me fondin e veçantë 2026	Buxhet planifikuar Janar-Prill 2026	Fakti Janar-Prill 2025	Realizimi kundrejt planit 4 mujor %
01150	Menaxhimi i të ardhurave Doganore	4,733,793,000	4,737,293,000	1,664,047,000	1,263,353,554	76

3. Informacion buxhetor i agreguar

Buxheti i fillestar i miratuar me anë të ligjit nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, programi buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave doganore”, është 4,733,793 mijë lekë ndarë sipas zërave buxhetor; Shpenzime korrente 4,406,573 mijë lekë dhe shpenzime kapitale 327,220 mijë lekë. Gjatë periudhës Janar-Pill 2026 ky plan ka pësuar vetëm një ndryshim në zërin e shpenzimet korrente si me poshtë:

1. Me shkresën e MFE nr. 677/15 prot, datë 12.02.2026, është përcjellë shkresa nr.677/3 datë 09.02.2026 me anë të së cilës është akorduar fondi i veçantë në shumën 3,500 mijë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur buxheti i akorduar dhe realizuar për periudhën Janar-Prill 2026 sipas artikujve buxhetor është si më poshtë:

Në 000/lekë							
Art	Emërtimi	Realizuar 2025	Plan fillestar viti 2026	Akordim fondi i veçantë	Plan i rishikuar 2026	Realizuar Janar - Prill 2026	Diferenca
600	Paga	1,446,832	1,589,830	0	1,589,830	494,159	1,095,671
601	Sigurime Shoqërore	235,737	258,853	0	258,853	80,856	177,997
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,080,564	2,547,875	0	2,547,875	674,341	1,873,534
605	Transferta Korente të Huaja	9,981	10,015	0	10,015	7,404	2,611
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,010		3,500	3,500	2,021	1,479
I	Shpenzime korrente	3,776,124	4,406,573	3,500	4,410,073	1,258,780	3,151,293
231	Kapitale të Trupëzuara	58,691	323,220	0	323,220	3,552	319,668
	Shp kapitale me financim të brendshëm	58,691	323,220	0	323,220	3,552	319,668
230	Kapitale të Patrupëzuara	1009	4,000	0	4,000		4,000
231	Kapitale të Trupëzuara	-		0	0	1022	-1,022
	Shp kapitale me financim të huaj	1009	4,000	0	4,000	1022	2,978
II	Shpenzime Kapitale	59,700	327,220	0	327,220	4,574	322,646
III	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	171,465	0	0	17,889	10,413	7,476
	Totali (korrente + kapitale)	4,007,289	4,733,793	3,500	4,755,182	1,273,767	3,481,415

4. Performanca e treguesve kyç të performancës në bazë gjinore, nivel produkti.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2026 numri faktik i punonjëve organik të administratës doganore ka qënë 972 nga të cilët femra 320 punonjëse. Numri aktual organik i punonjëve të sistemit doganor është miratuar anë të Vkm nr.10, datë 09.01.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar është 1074 punonjës, për këtë periudhë ka patur 102 vakanca.

5. Performanca e buxhetit në nivel programi

Qëllimi i Politikës së programit është: “Menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore”. Treguesi i performancës është Mbledhja faktike e të ardhurave krahasuar me parashikimet. Për periudhën Janar-Prill 2026 ky tregues performace u realizua në masën 96.8%. Në krahasim me periudhën Janar-Prill 2025 janë realizuar rreth 1,2 Mld lekë më shumë (101,7%). Duhet theksuar se kursi i këmbimit ka dhënë një ndikim tkurrës në realizimin e të ardhurave prej 2,6 Mld lekë. Pa këtë ndikim realizimi i planit do të ishte 100,1%. Mbivlerësimi i monedhës lekë ka një ndikim të konsiderueshëm në realizimin e planit të të ardhurave për administratën doganore, fenomen ky jashtë kontrollit të administratës sonë.

Për periudhën Janar-Prill 2026 u realizuan të ardhurat në mld lekë:

Muaji	Realizim 2025	Realizim 2026	Plan 2026	% 2026-2025	Diferenca 2026-2025	Realizimi 2026/ Realizimi 2025, %
Janar	16,385	16,008	17,349	97.7	-377	-2.30%
Shkurt	17,259	17,096	18,733	99.1	-163	-0.90%
Mars	19,166	19,778	19,371	103.2	611	3.20%
Prill	19,631	20,767	20,641	105.8	1,136	5.80%
Progresive	72,440	73,648	76,094	101.7	1,208	1.70%

Objektivat kryesore të programit janë:

- Krijimi i lehtësirave për operatorët ekonomik nëpërmjet lehtësimit dhe përsheptimit të procedurave doganore.
- Garantimi i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtare nga: kontrabanda, trafiqet paligjshme, mallrat e ndaluara e fallsifikuara, evazioni fiskal etj

Gjatë viteve të fundit, administrata doganore është udhëhequr nga parimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në raport me bizneset dhe qytetarët, në funksion të objektivave të saj, jo vetëm për mbledhjen e të ardhurave, por sidomos lehtësimin e procedurave dhe mbrojtjen e tregtisë së ligjshme dhe të ndershme. Informatizimi i procedurave dhe formaliteteve doganore, aplikimet online, veçanërisht përgjatë dy viteve të fundit, kanë lehtësuar aktivitetin prodhues, importues dhe (ri)eksportues të bizneseve dhe për periudhën në vijim synohet lehtësimi i mëtejshëm i procedurave doganore. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtrim të kohës proceduriale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

ADSH ka fuqizuar më tej aktivitetet dhe veprimet që kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë, ruajtjen në të mirë të shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Një rëndësi e veçantë i kustoet luftës kundër pastrimit të parave, shkeljeve ndaj IPR si dhe Materialeve të ndaluara si drogave si dhe mallrat radioaktive.

Gjatë periudhës Janr-Prill 2026 janë ushtruar kontrole në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme janë realizuar gjithsej 1602 inspektime doganore. Drejtoria e Antikontrabandës ka realizuar 1,310 kontrole, nga të cilat 483 ose rreth 37% kanë qenë të plota. Gjatë kontrolleve të ushtruara, janë zbuluar 66 raste me shkelje doganore, ku 39 raste me penalitet, me një vlerë totale 12,692,879 Lekë. Efektiviteti i kontrolleve me shkelje për periudhën Janar - Prill 2026, rezulton në masën 8.1%.

Kontrollet, janë ushtruar në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme. Drejtoria e kontrolleve të Akcizës ka ushtruar 24 kontrole ne operoret me statusin e depozituesit te miratuar (magazina fiskale) dhe importues te duhanit dhe 66 kontrole si pjese e grupeve te taskforces per kontrollin e karburanteve ne njesite e pikave te tregtimit me pakice ne bashkepunim me strukturat e DOH-se dhe tatimet.

Nga Drejtoria Antitrafik janë ushtruar 1045 kontrole nga të cilat kanë kryer 305 kontrole të autoboteve të naftës të cilët kanë ndjekur itinerarin DD Durrës Porto Romano – DD Morinë, dhe janë kontrolluar ne Degën e Doganës Kukës. Janë kryer 600 monitorime dhe kontrole me furgonin MDS të radioaktivitetit në pikat kufitare Morinë, Hani i Hotit, Muriqan, Vlorë dhe Durrës, për identifikimin e radioaktivitetit, materialeve apo lëndëve radioaktive në ngarkesa dhe mjete transporti si dhe 140 kontrole të lëvizjes së parasë cash dhe kontrolli i dërgesave postare.

Drejtoria e Hetimit, nisur nga informacione të strukturave të tjera të DPD-së, apo për çështje të nisura kryesisht pas mbledhjes së të dhënave si dhe kryerjes së veprimeve paraprake, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin penal në fushën e doganave për shmangie të detyrimeve doganore apo detyrimeve të akcizës sipas përcaktimeve të nenit 277 të ligjit nr. 102 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka përgatitur dhe ka dërguar pranë Organit të Prokurorisë gjatë kësaj periudhe 1 referim për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë” të parashikuar nga neni 174 i K.Penal’. Gjatë periudhës Janar – Prill 2026 kanë qenë në proces hetimi çështje me karakter sensitiv apo kërkesa për verifikim nga të cilat, janë trajtuar 1574 çështje dhe mbyllur 416 çështje.

Realizimi i treguesve të performancës:

Treguesit e Performancës	Realizuar viti 2025	Parashikuar viti 2026	Realizuar janar-prill 2025	Realizuar janar-prill 2026
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanal të verdhë	74'	61'	70'	76'
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanalin e kuq	496'	350'	443'	510'
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanalin jeshil	51'	25'	61'	31'
Numri i deklaratave doganore të procesuara në kanalin jeshil (në import)	175,903	257,143	53,453	54,946
Numri i deklaratave doganore të procesuara në kanalin jeshil (në export)	756,423	102,857	22,409	23,207
Numri i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO)	18	23	18	18
Numri i grave që punojnë në sistemin doganor	299	330	297	320
Numri i burrave që punojnë në sistemin doganor	685	744	675	652

Në periudhën Janar-Prill 2026 janë përpunuar 243,200 deklarata doganore, është ndër katërmujorët me numrin më të lartë të deklaratave të përpunuara ku numrin më të madh e ofrojnë deklarata e importit 4, të cilat janë deklarata që sjellin të ardhurat për administratën doganore, duke treguar edhe rritjen e numrit të deklarimeve në doganë.

Numri i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO). Çertifikata “Operatori Ekonomik i Autorizuar”, është një status i lëshuar për “tregtarët me besueshmëri” të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor-CEFTA. Deri në fund të vitit 2025 e kanë marrë këtë status gjithsej 18 operatorë ekonomik. Për periudhën janar-prill 2026 janë në proces për të përfituar këtë status edhe 6 operatorë të tjerë ekonomik.

Plani fillestar, plani i rishikuar si dhe realizimi i artikujve buxhetor për periudhën Janar-Prill 20256 paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë					
Art	Emërtimi	Plan fillestar Viti 2026	Plan rishikuar vjetor	Realizuar Janar-Prill 2026	% e realizimit ndaj planit të rishikuar
600	Paga	1,589,830	1,589,830	494,159	31%
601	Sigurime Shoqërore	258,853	258,853	80,856	31%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,547,875	2,547,875	674,341	26%
605	Transferta Korente të Huaja	10,015	10,015	7,404	74%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	3,500	2,021	58%
231	Financim i brendshëm	323,220	323,220	3,552	1%
230	Financim i Huaj	4,000	4,000	0	0%
231	Financim i Huaj	0	0	1,022	
	Shuma	4,733,793	4,737,293	1,263,354	27%

Realizimi i buxhetit të programit për periudhën Janar-Prill 2026 është 27% e planit të buxhetit të miratuar. Janë parashikuar të realizohen me fondet e miratuara të shpenzimeve korrente produktet e mëposhtme, ecuria e të cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

në 000/ lekë

Kodi produktit	Produkti	Plani fillestar	Plani rishikuar	shuma e realizuar	Sasia e realizuar
91005AA	Deklarata doganore të procesuara	2,642,673	2,646,173	698,400	243,200
91005AB	Vendime gjyqësore të ekzekutura	15,000	15,000	7,897	9
91005AC	Inspektime doganore të kryera	233,665	233,665	65,992	2,445
91005AD	Hetime doganore të kryera	15,000	15,000	1,346	416
91005AE	Shërbim i skanimit	1,500,235	1,500,235	485,145	5
	Shuma	4,406,573	4,410,073	1,258,780	

6. Projektet Kapitale

Me anë të ligjit nr. nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, janë planifikuar për tu realizuar investimeve në shumën 327,220 mijë lekë nga të cilat më financim të brendshëm 323,220 mijë lekë dhe me financim të huaj 4,000 mijë lekë

në 000/ lekë

Kodi projektit	Emërtesa e investimeve	Planifikuar 2026	shuma e realizuar	Sasia e realizuar
18AW101	Pajisje kompjuterike, licenca, softë	10,926		
18Aw103	Pajisje teknike	7,440	3,552	1
25AE501	Vendosja në funksion dhe përshtatja e godinës në të cilën do të ushtrrojë veprimtarinë administrata doganore	150,000		
25AE601	Blerje minibus per transport personeli	32,000		
18AË108	Skaner per kontroll Bagazhesh	11,000		
18AË109	Blerje Motorgjenerator	9,000		
25AE701	Rehabilitimi i Degës së Doganës Shkodër	28,866		
25AE801	Punime për riaftësimin e parkingut, territorit të D. Doganës Shkodër	25,242		
25AE901	Punime Ndërtimi dhe Rehabilitimi Pikës së Kalimit Kufitar Muriqan.	10,304		
25AF001	Veshje me tavan dhe sistem ndriçimi i tendave në terminalin e hyrjes dhe daljes të Degës së Doganës Kakavie	20,200		
25AF101	Punime për ndërtimin e nje korsie shtese dhe shtrese asfalti per sheshin dhe rrugen drejt kufirit	18,242		
25AA101	Customs Programme	4,000	1,022	
	Shuma	327,220	4,574	

Gjatë kësaj periudhe është realizur financimi për blerjen e pajisjes “Blerje e distilatorit automatik për përcaktimin e karakteristikave të distilimit në presion atmosferik të nënprodukteve të naftës, sipas standardit EN ISO 3405”.

7. Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Krahas fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit gjatë periudhës Janar-Prill 2026 janë realizuar shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit (kap6) si më poshtë:

në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Fond i krijuar	Fond i realizuar
1	Shpenzime personeli (600+601)	10,528	4,915
2	Shpenzime të tjera korente (602)	324	166
3	Shpenzime kapitale (231)	1,965	300
4	Transferta korrente të brendshme (art 604)	5,072	5,032
	TOTALI	17,889	10,413

Në shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga të ardhurat jashtë limitit përfshihen:
-Fondet e krijuara nga vendosja e sanksioneve doganore në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

-Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë si dhe nga operatorët ekonomikë në ambientet e të cilëve ka prezencë të personelit doganor.

-Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Prill 2026 në bazë të autorizimeve të lëshuara nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit nr.157/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 ‘Për taksat kombëtare, të ndryshuar’, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.12 datë 04.04.2017 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare’, të ndryshuar është kryer transfera prej 5,032 mijë lekë njësi vendore për rentën minerare të shfrytëzuar në teritorin e tyre (art 604).

8. Përfundime, ndryshime në buxhet

Me shkresë nr.8181prot, datë 27.04.2026 “Kërkohet rialokim fondi” është kërkuar nga ana e Institucionit tonë rishpërndarje e fondeve buxhetore ndërmjet projekteve të shpenzimeve kapitale të miratuara për tu kryer gjatë vitit 2026. Këto fonde do të përdoren për blerjen e 17 automjeteve për strukturat operative të Departamentit Operativ Hetimor si dhe për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale të vitit 2025, për pajisjen teknike të Laboratorit Doganor “Gazkromatograf Bidimensional” i cili do të shërbejë për kryerjen e analizave në gasoilin e anijeve të peshkimit.

Gjithashtu do të kërkohet edhe sistemim artikulli buxhetor për projektin 25AA101 “Customs Program” pasi me ligjin e buxhetit financimi i huaj është akorduar artikull 231 dhe në detajimin e investimeve është detajuar artikull 230.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja